

Tiranë, në 06.11.2013

NJOFTIM PËR SHTYP

Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar,

6 nëntor 2013

Në datën 6 nëntor 2013, u zhvillua takimi i rregullt i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Takimi u kryesua nga Ministri i Financave dhe në të morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetarja e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), dhe drejtues e ekspertë të këtyre institucioneve. Si edhe në takimet e mëparshme, në takim u ftuan dhe morën pjesë edhe përfaqësues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD).

Në fillim të takimit, të pranishmit u njohën me një përmbledhje të veprimtarisë së GKSF-së prej fillimit të vitit 2012, kur kjo veprimtari është mbështetur nga Sekretariati i posaçëm. Më tej, përfaqësuesit e AMF-së diskutuan mbi zhvillimet në tregun e sigurimeve, duke u ndalur më hollësisht në ecurinë e produktit të kartonit jeshil dhe mënyrën e vlerësimit të produkteve të sigurimit. Të pranishmit vlerësuan punën e AMF-së për të siguruar që rezervat teknike të shoqërive të sigurimit të jenë në përputhje me kërkesat minimale rregullative dhe nivelin e ekspozimit ndaj rreziqeve, si edhe theksuan nevojën që mënyra e çmimit të produkteve të sigurimit në treg t'i përgjigjet pritjeve të konsumatorëve për një shërbim efektiv dhe cilësor.

Në vijim, përfaqësuesit e ASD-së njohën të pranishmit me negociatat për të përfutur një linjë kredie nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si një instrument mbështetës për përmbushjen e objektivave lidhur me madhësinë e synuar të fondit për sigurimin e depozitave. BERZH ka ofruar një instrument të tillë

edhe për institucione homologe në vende të tjera të rajonit, të cilët e kanë parë atë si një mundësi të mirë për të zgjeruar burimet e tyre financiare. Opsioni i përdorimit të linjës së kredisë do të kërkonte një garanci të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Për të vlerësuar dhe arsyetuar detyrimet e mundshme që lindin në buxhetin e shtetit në rastin e përdorimit të kësaj linje kredie, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave theksuan nevojën që të vlerësohen në mënyrë më të plotë arsyet dhe mundësia e përdorimit të saj. Për të realizuar këtë proces, u sugjerua që ASD të bashkëpunonte me Bankën e Shqipërisë.

Përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë i njohën të pranishmit me vlerësimet e tyre për gjendjen financiare dhe ekspozimin e sektorit bankar ndaj rreziqeve kryesore. Ndonëse sektori bankar përballet me vështirësi për gjenerimin e një rezultati financiar pozitiv në mënyrë të qëndrueshme, ai mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Rritja e shpenzimeve të veprimtarisë, për shkak të krijimit të fondeve rezervë për përballimin e rrezikut të kreditit, është shoqëruar me ngadalësim të ndjeshëm të veprimtarisë së kreditimit. Në këto kushte, të pranishmit u njohën me veprimet dhe masat që Banka e Shqipërisë, më vete ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ka ndërmarrë për të trajtuar stokun dhe flukset e kredive me probleme. Këto masa përfshijnë ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile për mirëfunksionimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit, nxitjen e procesit të ristrukturimit të kredisë në një fazë të hershme të shfaqjes së problemeve për huamarrësin, komunikimin me autoritetet përgjegjëse për trajtimin tatimor të kredive të humbura që pastrohen nga bilanci i bankave dhe për nevojën e pagesës së detyrimeve të prapambetura për kompanitë e angazhuara në punë publike. Gjithashtu, për të nxitur kreditimin, kërkesat për kapital dhe për aktive likuide për bankat janë ulur përkohësisht. Banka e Shqipërisë i njohu të pranishmit me disa vlerësime paraprake për ndikimin e mundshëm të këtyre masave në ecurinë e kredive me probleme. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave vlerësuan pozitivisht veprimet e ndërmarra dhe theksuan nevojën që vlerësimet për ndikimin e këtyre veprimeve në ecurinë e kredive me probleme të zgjerohen me përfshirjen e skenarëve të tjerë të mundshëm. Lidhur me trajtimin tatimor të kredive që pastrohen nga bilancet e bankave, u theksua nevoja që palët të arrijnë në një interpretim të saktë dhe të qëndrueshëm të përcaktimeve ekzistuese ligjore dhe akteve të nxjerra në zbatim të tyre, për këtë proces.

Më tej, Banka e Shqipërisë bëri një paraqitje të ecurisë së projektit për sistemin e automatizuar të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve të emetuar nga qeveria (CSD). Ky sistem eliminon rrezikun e mosrespektimit të marrëveshjes nga palët në një transaksion me tituj, falë zbatimit të parimit "dorëzim kundrejt pagesës". Gjithashtu, për shkak të automatizimit të procesit dhe rritjes së pritshme të vëllimeve të tregtimit në tregun sekondar të titujve, investitorët do të plotësojnë më mirë nevojat e tyre për likuiditet në kushtet e një rreziku më të ulët operacional. Të pranishmit mbështetën sugjerimin e Bankës së Shqipërisë për nevojën e ngritjes së një grupi pune ndërinstytucional për mbështetjen e këtij projekti.

Në takim, diskutimet vijuan lidhur me situatën e likuiditetit në tregun ndërbankar dhe në tregun e titujve të borxhit të Qeverisë. Të pranishmit theksuan rëndësinë që mënyra e financimit të kërkesave për huamarrje të qeverisë, në respektim të buxhetit të miratuar, të reflektojë kapacitetet huadhënëse të operatorëve në tregun e brendshëm, si edhe të lejojë hapësirat e nevojshme për plotësimin e kërkesave për huamarrje nga sektori privat. Palët vlerësuan nevojën që, në respektim të përgjegjësive përkatëse ligjore në sferat fiskale dhe monetare, të vlerësojnë pritshmëritë për treguesit përkatës duke u mbështetur në disa skenarë. Këta skenarë duhet të identifikohen dhe të diskutohen paraprakisht mes palëve.

Në përfundim të diskutimeve për çështjet që parashikonte programi i mbledhjes, Ministri i Financave e deklaroi atë të mbyllur.